



www.legjisllacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 11

Tiranë – E hënë, 10 gusht 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Tregtar nr. 1693, datë 15.7.2015	Mbi shitjen me ankand të hapur të masës së falimentimit të shoqërisë në falimentim “Volalba”, sh.p.k..... 3

**VENDIM****Nr. 1693, datë 15.7.2015****MBI SHITJEN ME ANKAND TË
HAPUR TË MASËS SË FALIMENTIMIT
TË SHOQËRISË NË FALIMENTIM
“VOLALBA”, SHPK**

Gjykata, në seancën e datës 15 korrik 2015, ora 09:00, pasi u vu në dijeni propozimin datë 7.7.2015 të administratorit të falimentimit znj. Shpresa Breçani, për shitjen e masës së falimentimit të shoqërisë “Volalba”, vendimin e datës 9 korrik 2015 të Komitetit të Kreditorëve, për shitje me ankand të hapur të masës së falimentimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të administrimit të masës së falimentimit nr. 5, të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për rregullat e zhvillimit të ankandit publik”

VENDOSI:

1. Shitjen e masës së falimentimit të shoqërisë së falimentimit “Volalba”, sh.p.k. me ankand të hapur.

2. Realizimi i ankandit të bëhet nën mbikëqyrjen e administratores së falimentimit, e cila brenda këtij muaji korrik, sipas pikës 11-31 të standardit, të përcaktojë formatin e njoftimit të shitjes me ankand të hapur të shoqërisë “Volalba”, sh.p.k. në falimentim me përmbajtje:

Emrin e debitorit;

b) përmbledhjen e aktiveve që do të shiten;

c) mënyrën dhe kushtet e shitjes;

d) kohën dhe vendin për kontrollin e aktiveve;

e) kohën dhe vendin për zhvillimin e ankandit;

f) çmimin fillestar të shitjes;

g) shumat, të cilat palët e interesuara janë të detyruara të depozitojnë të paktën 3 ditë përpara zhvillimit të ankandit;

h) gjithashtu, njoftimi duhet të përmbajë, datën e depozitimit ose garancinë bankare, detajet mbi kushtet, mënyrën dhe vendin ku dokumentacioni do të dorëzohet;

i) përshkrimin e procedurës së shitjes;

j) afatin e fundit në të cilin blerësi është i detyruar të paguajë çmimin për shitjen që po bëhet;

k) afatin kohor për rimbursimin e depozitave;

l) emrin e administratorit të falimentimit dhe të dhënat përkatëse;

m) informacione të tjera të cilat administratori i falimentimit i konsideron të nevojshme.

3. Për të marrë pjesë në ankand, përveç njoftimit publik në dy gazeta me karakter kombëtar: Panorama, Telegraf, në faqen zyrtare të GJRRGJ-së Tiranë, faqen zyrtare të shoqërisë Volalba, sh.p.k. dhe ABSA (Autoriteti i Mbikëqyrjes së Administratorëve të Falimentimit) me shpenzimet e mbuluara nga masa e falimentimit dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare botimi i Qendrës së Botimeve Zyrtare. Në varësi të fondit të shpenzimeve për ankandin të publikohet edhe në një nga *Wëbsit*-et për njoftime, si: www.njoftime.com dhe në televizion karakterit kombëtar, apo në faqe të tjera ndërkombëtare.

4. Të lëshohet autorizimi për pikën 3 të këtij vendimi për administratoren e falimentimit për të shitur pjesë të masës së falimentimit për të mbuluar shpenzimet e realizimit të ankandit, pasi të përcaktohen me preventiv shpenzimet e ankandit.

5. Veçanërisht, të ftohen si pjesëmarrëse në ankand personat juridikë, tregtarë, të cilët kanë objekt të veprimtarisë së tyre, shitje, blerje të pronave, investime etj., si: Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë etj.

6. Përpara zhvillimit të ankandit të hapur, sipas pikave 5-10 të standardit administratorja e falimentimit, duhet të kryejë veprimet para shitjes si një vlerësim të vlerës së aktiveve të debitorit ose vlerën e biznesit si një i tërë etj.

7. Sugjerohet që zhvillimi i ankandit të hapur të kryhet brenda muajit shtator të vitit 2015 dhe masa e propozuar si e tërë dhe për çdo send në vetvete të mos jetë më pak se 80% të vlerës së vlerësuar.

8. Për masat e mëtejshme të ndërmarra nga administratorja e falimentimit të vihet në dijeni Gjykata e Falimentimit.

9. Ky vendim pasi iu bë me dije palëve prezent të publikohet në faqen zyrtare të GJRRGJ Tiranë, faqen zyrtare të shoqërisë Volalba, sh.p.k dhe ABSA, në buletin e Njoftimeve Zyrtare, botimi i Qendrës së Botimeve Zyrtare.

**GJYQTARE
Rezarta Mataj**

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.